



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

Nr. 13387 prot.

Tiranë, më 23.7.2021

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

**DREJTORIVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTEGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 "Për personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Inspektor Antikontrabande**, në Sektorin e Antikontrabandës Tokësore, në Drejtorinë e Antikontrabandës, Kategoria C2/ IV- a, 3 (tre pozicione pune)

Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Bachelor në Shkencat Ekonomike, Natyrore, ose të lidhura me Sigurinë dhe Hetimin
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Zbaton legjislacionin për çështje që kanë të bëjnë me kontrabandën.
- Lexon dhe kupton legjislacionin dhe aktet administrative që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti ose jo me kompetencat e Drejtorisë, Informohet për ndryshimet/amendimet më të fundit që prekin punën e Sektorit të Antikontrabandës Tokësore. Siguron zbatimin e duhur të ligjit lidhur me rastet që kanë të bëjë me kontrabandën, evazionin fiskal dhe borxhin.
- Zbaton me efikasitet dhe në kohë udhëzimet/detyrat e ngarkuara nga Komandant i grupit perkates.
- I raporton Komandantit të grupit përkatës dhe nëpërmjet tij Përgjegjësit të Sektorit të Antikontrabandës Tokësore për zbatimin e urdhërave dhe detyrave të marra.
- Zbaton me korrektësi urdherat dhe detyrat e marra, kontrollet, në përputhje me Kodin doganor.
- Vendos para përgjegjësisë ligjore të gjithë ata subjekte që kryejnë veprime të paligjshme për t'iu shmangur kontrollit doganor ose që kryejnë cdo lloj trafiku të paligjshëm.
- Kontrollon në aks-rrugor dokumentacionin e mallrave, të mjeteve, si dhe të udhëtareve që hyjnë nga zona doganore drejt territorit shqiptar.
- Sugjeron përgjegjësit të grupit përkatës, për përcaktimin me rrisht të mjeteve, kur ka arsye apo dyshime se në to mund të ketë diferencë në sasi peshë, shmangie në natyrë malli, apo mangësi të tjera në dokumentacion.
- Ndhomon në përpilimin e dokumentacionit përkatës në rastin e konstatimit të shkeljeve doganore dhe t'ja dorëzojë Kryetarit të Doganës për marrjen e vendimit përkatës.
- Garanton zbatimin e urdhërave dhe vendimeve:
 - Për subjektet dhe mjetet që i janë shmangur kontrollit dhe pagimit të detyrimeve doganore.
 - Për sekuestrimin dhe konfiskimin e mallrave .
 - Për vjeljen e gjobave dhe të cdo lloj detyrimi tjetër administrativo-ligjor.
- Kryen detyra administrative dhe pune teknike, përfshirë organizimin, mbikqyrjen dhe menaxhimin e të gjitha aspekteve të punës në Grupin përkatës të Antikontrabandës Tokësore.
- Kryen veprimtari teknike dhe administrative për të evidencuar e plotësuar në mënyrë periodike të dhënat statistikore për drejtimet e punës që mbulon duke zhvilluar dhe analiza për tendencat e kontrabandës dhe format e shfaqjes së saj.
- Respekton plotësisht dhe pajtohet me Rregullat e Etikës së Administratës Doganore dhe përgjigjet për raportimin e menjërshtë të çdo shkeljeje

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim (e-mail, dhe numër telefoni)
2. Curriculum Vitae

3. Fotokopje e Diplomës dhe lista e notave të noterizuara
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penaliteti
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Letër referencë dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Përvojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 02.08.2021, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra Sekretari/Protokollit.

DREJTORI PËRGJITHSHËM
Genti Gazheli

